

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

EURO MEGA 2010

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K91624505A

NUIS/NIPT

Fshati Ahemtaq, prane firmes Ital Kon.

Adresa

Tiranë

Albania

1023

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682021549

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

euromega2010@gmail.com

E-mail

ADMINISTRATORI Redina Shametaj

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/04/17

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0682021549

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-65600-04-11-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

2083333

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Materiale Pastrimi

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/04/25

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/04/25

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/11908/04112023

33711430-033770000-839224100-939831200-

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Shoqëria “EURO MEGA 2010” SHPK është një shoqëri e cila e ushton aktivitetin e saj tregëtar ndër të tjera edhe në fushën e prodhimit të detergjenteve të llojeve të ndryshme. Tregëtim me shumice dhe pakice, import, eksport të detergjenteve dhe mallrave të ndryshme industrial, bujqësor, ushqimor, pijeve freskuese e alkolike, blektoral, lendeve të para për industrinë, duralumini, hidrosanitare, elektro shtëpiake, elektronike, elektrike. Etj., Shoqëria ka interes të marrë pjesë dhe të paraqesë ofertën e saj për procedurën e prokurimit të cituar më sipër.

Më datë 12/04/2023, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar nga autoriteti kontraktor, Njesia Vendore e Kujdesit Shendetësor Shkoder, procedura e prokurimit: “E hapur, e thjeshtuar”, me numër reference të procedurës: REF: 65600-04-11-2023, me objekt: “MATERIALE PASTRIMI”.

Në dokumentat e tenderit në Shtojcën “Secifikimet teknike” të DT janë përcaktuar specifikimet teknike për 2 produkte si më poshtë:

- Milva 3 kg Në pako 3 kg;
- Mastrolindo Me shishe plastike, 1 liter;

Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 7 të DT janë vendosur kriteret për kualifikim si më poshtë:

I- Në pikën 2 të Kapacitetit teknik është kërkuar: “ 2.Një punësim mesatar i të paktën 6 personave për periudhën dhjetor 2022-shkurt 2023 të vërtetuar me;
-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën përkatëse

-List pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore.

-Minimalisht 2 shofera, 1 pastrues të deklaruar në listepagesa me kodin përkatës.”

II- Në pikën 3 të Kapacitetit teknik është kërkuar:”3.Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni e vërtetuar me dokumentacionin përkatës tekniko - ligjor (ambjente në pronësi apo me qera) (ose të kenë pike kontakti në rrethin e Shkodrës si adrese të dytë , të vërtetuar me dokumentacion përkatës tekniko - ligjor, i regjistruar në qkr si adrese e dytë e ushtrimit të aktivitetit dhe i pajisur me vërtetim debie nga FSHU) pasi specifikat e këtij institucioni kërkojnë që furnizimi të garantohet në çdo ditë dhe çdo orë të kërkuar sipas kërkesave të AK deri me datë 15.12.2023..”

III- Në pikën 7 të Kapacitetit teknik është kërkuar: ..”Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqeruara me certifikate cilesie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor...”.

IV- Në pikën 8 të Kapacitetit teknik është kërkuar: “Operatoret ekonomik duhet të paraqesin në SPE Certifikatën CE për të gjithë artikujt pjesë perberëse të preventivit.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se

përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Ne nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP përcaktohet:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet?

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

Në nenin 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet:

”Neni 77 (Kërkesat për kualifikim)

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Në nenin 40 të VKM 285/2021 për kontratat e mallrave përcaktohet si më poshtë vijon:

Neni 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave)

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të

prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t'argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur.”

1- Në lidhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit në Shtojcën “Specifikimet teknike” të DT ku janë përcaktuar specifikimet teknike për 2 produkte si më poshtë:

- Milva 3 kg Në pako 3 kg;

- Mastrolindo Me shishe plastike, 1 liter;

Pretendojmë se, specifikimet teknike të produkteve të mësipërme janë vendosur në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 36 (Specifikimet teknike) të ligjit Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi AK-ja ka përcaktuar marka konkrete dhe kjo është në kundërshtim me ligjin pasi pengon pjesëmarrjen e të gjithë OE të cilat nuk i tregëtojnë këto marka.

Në përfundim kërkojmë heqjen ng specifikimet teknike të markave tregëtare ”Milva” dhe “Matrolindo”.

2- Në lidhje me kriterin për kualifikim të vendosur në dokumentat e tenderit në Shtojcën 7 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) pika 2, në të cilin kërkohet dokumentacion për të vertetuar se shoqëria ka në stafin e saj 1 (një) pastrues të deklaruar në listepagesa me kodin perkates për periudhën dhjetor 2022-shkurt 2023, kërkohet heqjen e kësaj kërkesë pasi nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe kufizon konkurrencën dhe pengon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi në mënyrë të paligjshme për asryet e mëposhtme:

Objekti i prokurimit është MALL dhe jo shërbim. Konkretisht kërkohet që OE të furnizojnë Autoritetin kontraktor me një listë me produkte me materiale të ndryshme pastrimi dhe nuk kemi të bejmë me një procedurë prokurimi të kategorisë – shërbim, ku të kërkohet shërbim pastrimi ku të jetë e nevojshme stafi me punonjës pastrimi.

Profili ”pastrues”, është kërkesë e kzagjeruar, e cila penalizon operatorët ekonomikë në mënyrë të paligjshme, kufizon pjesëmarrjen e tyre për shkak se kjo kërkesë për kualifikim nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës objekt prokurimi, nuk është një kërkesë e cila është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor që, ofertuesi ka kapacitetet dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet, për sa kohë që në asnjë nga zërat e preventivit nuk parashikohet shërbimi i pastrimit, për pasojë është në kundërshtim me nenin 77 të LPP-së.

Për çfarë i duhet AK-së një punonjës me profilin ”pastrues” kur në asnjë nga zërat e preventivit nuk është kërkuar shërbim pastrimi??

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave autoriteti kontraktor nuk jep asnjë argument përse është e nevojshme të jenë në stafin e operatorit ekonomik pikërisht ky lloj profili.

Kemi të drejtën të dyshojmë se kjo kërkesë është e vendosur për të favorizuar operatorë të caktuar dhe për të përjashtuar operatorët e fushës objekt prokurimi.

Në përfundim, kërkohet heqjen e kriterit për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) pika 2, në të cilin kërkohet dokumentacion për të vertetuar se shoqëria ka në stafin e saj 1 (një) pastrues të deklaruar në listepagesa me kodin perkates për periudhën dhjetor 2022-shkurt 2023.

3- Në lidhje me kriterin për kualifikim të vendosur në dokumentat e tenderit në pikën 3 të Kapacitetit teknik ku është kërkuar:”3.Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni e vertetuar me dokumentacionin perkates tekniko - ligjor (ambjente në pronësi apo me qera) (ose të kenë pike kontakti në rrethin e Shkodrës si adrese të dyte , të vertetuar me dokumentacion perkates tekniko - ligjor, i regjistruar në qkr si adrese e dyte e ushtrimit të aktivitetit dhe i pajisur me vertetim debie nga FSHU) pasi specifikat e këtij institucioni kerkojne qe furnizimi te garantohet ne cdo dite dhe cdo ore te kerkuar sipas kerkesave te AK deri me date 15.12.2023..” kërkohet heqjen e këtij kriteri për arsytet e mëposhtme:

Kriteri i mësipërm është absurd dhe në kundërshtim të hapur me legjislacionin e prokurimeve, vjen në kundërshtim të hapur me qëllimin dhe parimet e përgjithshme të këtij ligji e konkretisht me nenin 2 dhe nenin 3 të LPP ku përcaktohet:

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

4- Kërkesa për kualifikim që: “Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni...” jo vetëm që nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe nuk është proporcionale me objektin e kontratës, nuk gjen mbështetje as në nenin 77 të LPP-së dhe as në nenin 40 të VKM 285/2021, por mbi të gjitha është diskriminuese, kufizon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë pasi përjashton nga pjesmarrja të gjithë OE të cilët nuk kanë selinë apo dege të saj në qytetin e Shkodrës, por që nga ana tjetër mund të ofertojnë mallra më cilësi dhe me cmime më konkurruese se OE vendas të qytetit të Shkodrës. AK-së duhet të interesojë të sigurojë mallra me cilësi të mirë dhe me cmime konkurruese pavarësisht faktit se ku e kanë selinë këta operatorë.

Kjo dukshëm është vendosur për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë, në kundërshtim kjo të hapur me ligjin.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) pika 3 me përmbajtjen si më poshtë:

”3. Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni e vertetur me dokumentacionin përkatës teknik - ligjor (ambjente në pronësi apo me qera) (ose të kenë pikë kontakti në rrethin e Shkodrës si adrese të dyte, të vertetur me dokumentacion përkatës teknik - ligjor, i regjistruar në qkr si adrese e dyte e ushtrimit të aktivitetit dhe i pajisur me vertetim debie nga FSHU) pasi specifikat e këtij institucioni kërkojnë që furnizimi të garantohet në cdo ditë dhe cdo orë të kërkuar sipas kërkesave të AK deri me datë 15.12.2023..”

5- Në lidhje me kriteret për kualifikim të vendosura në dokumentat e tenderit në pikën 7 të Kapacitetit teknik ku është kërkuar: ”Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqeruara me certifikate cilësie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor...”

dhe në pikën 8 të Kapacitetit teknik është kërkuar: “Operatorët ekonomik duhet të paraqesim në SPE Certifikatën CE për të gjithë artikujt pjesë perberese të preventivit”, i kundërshtojmë për arsyet e mëposhtme:

Së pari:

Kriteri i përaktuar në pikën 7 të Kapacitetit teknik, të DT-së, është i paqartë pasi nga njëra anë kërkon që ”...Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqeruara me certifikate cilësie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre” dhe nga ana tjetër në këtë kriterin për kualifikim deklarohet se:

“...Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor...”

Ak-ja duhet të sqarojë nëse, certifikatat e cilësisë dhe të origjinës të mallrave, OE fitues do të paraqesë në Autoritetin kontraktor kur të lëvrojë mallin, pra pas lidhjes së kontratës së furnizimit apo pas njoftimit si i kualifikuar dhe i renditur i pari, apo gjatë vlerësimit të ofertave nëse kërkohen

sqarime nga autoriteti kontraktor???

Ky kriter është i paqartë dhe krijon konfuzitet tek OE-të gjatë përgatitjes së ofertës, KVO-së gjatë vlerësimit të ofertave dhe nga ana tjetër është një kriter që të krijon dyshimin se OE nuk do të trajtohen dhe vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese.

Kur AK kërkon certifikata cilësie e ka fjalën për certifikata CE??

Sqarimin tuaj.

Së dyti:

Mallrat e kërkuar nga AK-ja në këtë procedurë prokurimi janë mallra të cilat i gjen lehtësisht në treg dhe që nisur nga natyra e tyre, prodhuesit, distributorët apo tregëtarët nuk e kanë detyrim ligjor që në nxjerrjen e tyre në treg detyrimisht ti shoqërojnë këto mallra me certifikata cilësie apo origjine apo për me tepër më certifikata cilësie CE. Kërkohen 53 artikuj të ndryshëm dhe referuar edhe llojit të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” ku afati i dorëzimit të ofertave është 10 ditë për gjithë kata artikuj është e pamundur të sigurosh dokumentacionin si certifikata cilësie, certifikata CE nëse ekzistojnë apo certifikatat e origjinës së tyre.

Ak-ja nuk mund të kërkojë të paraqiten në tender, certifikime për mallrat për të cilat ligji nuk ja kërkon prodhuesit/distributorit/ tregëtarit si kusht për vendosjen e tyre në treg.

Një kriter i tillë pengon dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me ligjin.

Së treti:

Kërkesa që OE- të duhet të paraqesin në SPE certifikata CE për të gjithë mallrat objekt prokurimi është një kërkesë e ekzagjeruar, e pamundur për tu realizuar pasi, Certifikata CE zbatohet për të gjitha produktet e prodhuara si në vendet e Bashkimit Europian dhe të eksportuara jashtë Bashkimit Evropian. Disa hapa janë të nevojshme për të marrë një Certifikatë CE ose për të aplikuar Markën CE. E para nga këto hapa është përcaktimi i kërkesave të produktit në drejtim të direktivave të Bashkimit Evropian. Për shembull, lodrat, pajisjet elektrike, makineritë, pajisjet medicinale, ashensorët dhe pajisjet mbrojtëse personale janë produktet dhe grupet e produkteve që aplikojnë CE Marking. Direktivat përkatëse përcaktojnë kërkesat themelore që duhet të përmbushin produktet. Pra jo të gjitha produktet duhet të marrin markimin apo certifikatën CE.

Materilet e pastrimit në vlerësimin tonë nuk përfshihen në listën e produkteve për të cilat duhet të sigurohen certifikatat e cilësië CE.

Theksojmë se referuar nenit 9, pika 3 të Ligj Nr.10489/2011 markimi CE i konformitetit vendoset vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar vendosja nga rregullat teknike dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera. Psh, vendosja e markimit CE në detergjentë jo vetëm nuk është kriter, por është në kundërshtim me Ligjin Nr.10489/2011.

Rregullat për vendosjen në treg të detergjentëve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjentët në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik e të mjedisit përcaktohen në Ligjin Nr.10216 Datë 21.01.2020 “Për Detergjentët” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (VKM Nr.669/2011 “Për etiketimin e të dhënave të përbërësve në detergjentë”, VKM Nr. 220/2012 “Për Përcaktimin E Standardeve, Metodave Të Testimit Dhe Kufijtë E Lejuar Për Biodegradimin E Detergjenteve Dhe Vlerësimin E Rrezikut Për Lëndët Tensioaktive Në Detergjente”).

Gjithashtu, detergjentët duke qënë përzierje kimike, duhet të jenë në përputhje edhe me kërkesat e parashikuara për to sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e kimikateve, (Ligj Nr.27/2016 Për menaxhimin e Kimikateve , VKM Nr 488/2016 Për Klasifikimin, Etiketimin Dhe Ambalazhimin E Kimikateve). Ky kuadër ligjor thelbësisht kërkon që për përzierjet kimike (konkretisht, detergjentët), përdoruesve (konsumatorit) ti komunikohen qartë të dhënat për vetitë e rrezikshme dhe për përdorimin e sigurtë të tyre nëpërmjet vendosjes së duhur të deklaratave të parandalimit të

rrezikut, paralajmërimeve, piktogramave.

Në konkluzion, detergjentët janë objekt kontrolli për zbatimin e kuadrit ligjor të referuar më lartë, jo të dispozitave të Ligjit Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Për rrjedhojë, nuk është kriter ligjor vendosja në dispozicion e çertifikatës së konformitet nga ente të akredituara nga DPA, deklaratë konformiteti, apo vendosja e markimit CE sipas Nenit 9.

Sa më sipër argumentuarm kërkojmë:

- Ndryshimin e pikës 7 të Kapacitetit teknik, të DT-së, dhe kriteri të prckatohet si më poshtë:“..Mallrat duhet te jene origjinale”.
- Heqjen e kriteri të prckatuar në pikën 8 të shtojcës 7 të DT.

Pretendimet tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në përfundim, të nderuar zyrtarë të autoritetit kontraktor, pavarësisht sa më sipër, mbetemi me shpresë se, pretendimet dhe ankesa e paraqitur në këtë formular ankese, do të pranohet nga ana juaj dhe se gjatë shqyrtimit të kësaj ankese do të udhëhiqeni nga profesionalizimi, integriteti profesional, paanshmëria, zbatimi me korrektesë i ligjit dhe i rregullave të prokurimit publik.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose

një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. □

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

euomega2010@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Redina Shametaj